



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.226, datë 16.09.2022

PËR  
“CAKTIM TË PËRKOHSHËM”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. **Zoti Kleanth Zeka**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.
2. Zoti Kleanth Zeka, do të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, nga data 23.09.2022 - 22.12.2022.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, zoti Zeka do të paguhet me pagën e pozicionit të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.
4. Të njoftohen për këtë vendim zoti Kleanth Zeka, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 16.09.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**KRYETAR**  
Alfred Balla

Anëtar  
Sokol Stojani

ANËTAR  
Elaida Goxhi

ANËTAR  
Bujar Sheshi

ANËTAR  
Esmeralda Keshi

ANËTAR  
Mirela Bogdani

ZV/KRYETAR  
Tartar Bazaj

ANËTAR  
Nurihan Seiti

ANËTAR  
Zeqir Hoda